

Bud Dedaj, drejtor i

"Vus Austria" në

Prishtinë, pohon se studentët serbë të

Kosovës deri më tash nuk kanë qenë të interesuar për shumë projekte

Në shumë projekte me karaktere të ndryshme, që organizohen qoftë nga organizma vendorë apo ndërkombëtarë, studentët serbë të Kosovës deri më tash nuk kanë shprehur gatishmërinë për të qenë pjesëmarrës. Njëra ndër arsytet është se ata nuk dëshirojnë të jenë pjesë në këto projekte që udhëhiqen nga shqiptarët. Bud Dedaj, drejtor i "Vus Austria" në Prishtinë, pohon se studentët serbë të Kosovës deri më tani nuk kanë qenë të interesuar për shumë projekte. Sipas tij, organizata austriake punon dhe është në shërbim të të gjithëve.

"Të gjitha projektet që janë bërë në kuadër të "Vus Austria" dhe të Universitetit janë bërë për rininë e Kosovës, e cila është një rini që punon dhe premtton shumë", ka potencuar ai. Sipas Dedajt, në projektet e kaluara ata kanë pasur studentë të nacionalitetëve të tjera dhe se ata kanë kaluar shumë mirë. "Studentët serbë të Kosovës nuk kanë qenë pjesëmarrës në asnjë projekt. Ne nuk i dimë arsyet se pse

Studentët serbë të Kosovës, të painteresuar për projekte

Jo projekteve që udhëhiqen NGA SHQIPTARËT

dikush që të ndryshojë imazhi për studentët e Kosovës. Studenti nga Kroacia, Davor Filipović, i cili ka qenë edhe në Prishtinë në projekte të ndryshme dhe në Mitrovicë, ku është i përqendruar komuniteti serb, ka thënë se studentët serbë kanë mendime të ndryshme për shqiptarët e Kosovë dhe për vetë studentët shqiptarë, duke mos i konsideruar si gjë pozitive. "Politika e bën të veten dhe për shumë arsye ata nuk dëshirojnë të jenë pjesë e zhvillimeve të përgjithshme në Kosovë, duke përfshirë edhe arsimin", ka thënë ai.

Studenti serb nga Beogradi, Aleksandër Ribah, i cili po e ndjek universitetin dimëror, pohon se këtu s'ka kurrfarë problemi që të mos marrë pjesë në projektet që organizohen në Kosovë, përkundrazi ai thotë se çdo ditë e më mirë po bëhet këtu. "Unë kam qenë edhe më parë dhe prapë do të vij dhe se jam shumë i lumtur që më jepet rasti të rri me të rinjtë kosovarë", shprehet ai.

A. BELA



bashkëpunosh me studentët serbë të Beogradit sesa të Kosovës, pasi që ata nuk dëshirojnë që të bashkëpunojnë me ne. "Ne kemi Universitetin Veror të Prishtinës dhe çdo vit ka një numër të studentëve serbë, të cilët vijnë nga Serbia dhe nuk kemi kurrfarë problemi", ka thënë ai. Ai mendon se studentët serbë të Kosovës janë të keqinformuar për Kosovën dhe Prishtinën, andaj duhet të merret

ata nuk dëshirojnë të jenë pjesë e projekteve tona", ka vlerësuar ai. "Vus"-i austriak, që nga hapja e kësaj zyre, ka përdorur emrin zyrtar të Prishtinës. "Ne nuk kemi pasur kurrfarë problemi dhe për këtë jemi të kënaqur me bashkëpunimin që e kemi pasur me të gjithë faktorët në Kosovë", ka përfunduar ai. Ndërsa studenti i Universitetit të Prishtinës, Nehat Nikqi, pohon se më lehtë është të

KOSOVA SOT; 03.02.2009; Pg.8